

## **NJOFTIM PËR SHTYP**

### **MBI MBLEDHJEN E PARË TË ZHVILLUAR NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE TË CILAT PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR TË QENË PJESË E KOMISIONIT TË SHOQËRISË CIVILE QË DO TË KRYEJNË VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATURAVE PËR ANËTARIN QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË**

Më datë 18 shtator 2023, ora 11.00, në ambjentet e institucionit të Avokatit të Popullit u zhvillua mbledhja e pare e organizatave të shoqërisë civile që plotësojnë kriteret ligjore për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile.

Prezent në këte takim ishin përfaqësuesit e organizatave të mëposhtme:

- ✓ Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë
- ✓ Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"
- ✓ Qendra "Qëndresa Qytetare"
- ✓ Fondacioni "Kontribut për Edukim"
- ✓ Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm
- ✓ Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm
- ✓ Qendra për Çështjet e Informimit Publik "Infoçip"
- ✓ Shoqata "Drejtësia Sociale"
- ✓ Klinika Ligjore "Wisdom"

Duke qenë se janë më shumë se 5 organizata që plotësojnë kriteret ligjore për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile, qëllimi i takimit ishte zhvillimi i procedurave për përzgjedhjen me votim të fshehtë të organizatave që do jenë anëtarë të këtij komisioni.

Gjatë diskutimeve përfaqësuesit e organizatave pjesëmarrëse u dakortësuan mbi nevojën e njohjes paraprakisht me veprimtarinë dhe aktivitetet e kryera nga secila organizatë pjesëmarrëse në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

Sa më sipër, organizatat pjesëmarrëse vendosën që votimi i fshehtë në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të shoqërisë civile të zhvillohet ditën e mërkurë, më datë 20 shtator 2023, ora 15.00, pranë ambjenteve të institucionit të Avokatit të Popullit.